



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 12
Prishtinë, më 20.2.2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Aida Dërguti, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Elmi Reçica, Evgjëni Thaçi-Dragusha, Sergjan Mitroviç dhe Zafir Berisha.

Munguan: Danush Ademi dhe Visar Ymeri.

Në mbledhje ishte i pranishëm për raportim, Avni Arifi, shef i negociatave me Serbinë, me bashkëpunëtorët: Alban Dermaku, Meliza Haradinaj- Shtublla dhe Halil Matoshi.

Pjesëmarrësit e tjerë: Egesa Vitija, praktikante, Vlora Nushi, OPA/UNMIK, Blerta Bejtullahu, EUSR/ EU Office, Artan Murati, KDI, Butrint Berisha, PIPS dhe media.

Nga stafi i Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 30 janar dhe 9 shkurt 2018;
3. Raportim i shefit të negociatave me Serbinë, z. Avni Arifi lidhur me platformën e Qeverisë së Kosovës për procesin e dialogut Kosovë-Serbi;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 30 janar dhe 9 shkurt 2018

Kryetarja konstatoi se komisioni i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 30 janar dhe 9 shkurt 2018.

3. Raportim i shefit të negociatave me Serbinë, z. Avni Arifi lidhur me platformën e Qeverisë së Kosovës për procesin e dialogut Kosovë-Serbi

Vjosa Osmani-Sadriu, tha se z. Arifi është ftuar që të raportojë në komisioni, lidhur me gjendjen e marrëveshjeve të arritura dhe ta njoftojë komisionin me platformën e Qeverisë së tanishme për dialogun. Në vazhdim, bazuar në rezolutat e Kuvendit, që janë në fuqi, presim që Qeveria të ketë një plan konkret për temat që synon t'i propozojë dhe me vijat e kuqe që i ka Republika e Kosovës. Kërkoj që para dhe pas çdo dialogu në Bruksel, të njoftohet komisioni lidhur me rezultatin e arritur.

Avni Arifi, tha se po synohet që procesi i negociatave të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe ftoi partitë parlamentare që ta kenë një përfaqësues në ekipin negociator. Ai, po ashtu, njoftoi se deri më tani nuk është takuar me delegacionin serb dhe se janë takuar vetëm me përfaqësuesit e BE-së. Më tej, njoftoi se takimi i radhës do të mbahet më 26 shkurt 2018, ku do të bisedohet për implementimin e marrëveshjeve të arritura që kanë ngecur në implementim. Lidhur me marrëveshjet e arritura, tha se Kosova në shumicën e marrëveshjeve i ka kryer obligimet e veta, kurse sa i përket mosimplementimit të marrëveshjes për tabelat e veturave, njoftoi se ka ngecje, për shkak të procedurave të tenderimit. Synimi i ekipit negociator, tha se është përmbyllja e dialogut dhe përgatitja e bazës politike për arritjen e marrëveshjes përfundimtare. Ai tha se nuk e kanë për orientim fillimin e bisedimeve për marrëveshje të reja, por synojnë implementimin e marrëveshjeve ekzistuese.

Vjosa Osmani-Sadriu, tha se është esenciale që Kuvendi të përfshihet në procesin të dialogut, dhe para arritjes së marrëveshjeve, të sqarohet se cili do të jetë qëndrimi i Republikës së Kosovës. Lidhur me marrëveshjen, që ka të bëjë me Asociacionin e komunave serbe, pyeti: A është prioritet i Qeverisë krijimi i asociacionit të komunave serbe dhe a do të bëhet kjo në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese? Cili është qëndrimi i Listës Serbe lidhur me krijimin e asociacionit dhe a janë mbajtur takime lidhur me statutin e asociacionit? Sa i përket marrëveshjes për drejtësi, tha se në Kuvend është duke u diskutuar lidhur me një marrëveshje të ndërmjetme apo konkluzione, të cilat janë arritur në vitin 2013, në të cilat ndër të tjera pranohen vendimet gjyqësore të institucioneve paralele, të cilat bien në kundërshtim me tekstin e marrëveshjes për drejtësi. Lidhur me këtë, kryetarja kërkoj sqarime me shkrim se nëse ekziston kjo marrëveshje, dhe nëse ekziston, atëherë Qeveria dhe Kuvendi duhet të marrin masa për ta shpallur atë të pavlefshme, sepse është në kundërshtim me marrëveshjen për drejtësi.

Avni Arifi, njoftoi se nuk do të shkohet në Bruksel për të arritur ndonjë marrëveshje të re, por të bisedohet për marrëveshjet ekzistuese, disa prej të cilave kanë ngecur në zbatim, për shkak të çështjeve administrative e disa për shkak se mungon vullneti politik. Sa i përket asociacionit, njoftoi se qëndrimi i Qeverisë është që të respektohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Ai, po ashtu, njoftoi se nuk ka ndonjë informacion për mbajtjen e takimeve për draftimin e ri e të statutit të asociacionit të komunave. Sa i përket marrëveshjes për drejtësi, tha se ka informacion se ekzistojnë 2500 lëndë të vjetra, nga të cilat 1700 janë lëndë civile dhe rreth 800 janë penale. Ato po shqyrtohen nga ekspertë të USAID dhe se nuk ka njohuri se ekziston një marrëveshje që të njihet statusi i tyre.

Vjosa Osmani-Sadriu, lidhur me marrëveshjen për drejtësi, shprehu mendimin se nëse kjo marrëveshje nuk ekziston, atëherë Qeveria dhe Kuvendi duhet të dalin zyrtarisht dhe të thonë që marrëveshja e cila po qarkullon nëpër media është jo-ekzistuese. Ajo tha se duhet të njoftohet Këshilli Gjyqësor i Kosovës që ajo marrëveshje është jo-ekzistuese, sepse nëse Qeveria nuk ka informata për të, atëherë do të thotë që nuk ka ekzistuar një marrëveshje e tillë. Sa i përket marrëveshjes për asociacionin, tha se edhe qëndrimi i Qeverisë së kaluar, por edhe qëndrimi i znj. Mogherini është që asociacioni duhet të bëhet në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Ajo pyeti se nëse ka ndonjë lëvizje në këtë drejtim dhe se a ka interesim që të vazhdohet drejt hartimit të statutit të këtij asociacioni.

Avni Arifi, duke iu referuar pyetjes së znj. Osmani- Sadriu, tha se nuk është në dijeni nëse është ndërmarrë ndonjë hap për hartimin e statutit dhe se qëndrimi i Qeverisë është që statuti i asociacionit duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Dukagjin Gorani, duke iu referuar dokumentacionit të prezantuar nga z. Arifi, në pikën 1, në të cilën thuhet: “përmbyllja e dialogut dhe përgatitja e bazës politike për arritjen e marrëveshjes përfundimtare për normalizim”, pyeti: Çfarë do të thotë marrëveshja përfundimtare për normalizim? Tek pika 3, “parimi gjithëpërfshirës dhe transparencës së plotë”, pyeti: Çka nënkuptohet me gjithëpërfshirje? Te pika 4, “orientimi se nuk do të ketë marrëveshje të reja deri pas arritjes së marrëveshjes përfundimtare”, pyeti: Si nuk do të ketë marrëveshje të reja deri pas arritjes së marrëveshjes përfundimtare?

Avni Arifi, sa i përket pyetjes së deputetit Gorani, se çfarë do të thotë marrëveshja përfundimtare, tha se me marrëveshje përfundimtare nënkupton njohje reciproke. Me gjithëpërfshirje, tha se nënkupton përfshirjen e të gjitha partive parlamentare në dialog dhe me këtë rritet transparenca. Lidhur me pyetjen e deputetit Gorani, që ka të bëjë me pikën 4 të dokumentacionit, z. Arifi tha se orientim e kanë implementimin e marrëveshjeve ekzistuese dhe pastaj do të krijohet një situatë ku duhet të ndodhë normalizimi.

Dukagjin Gorani, shtroi pyetjen: A po llogaritet që përmbushja e marrëveshjeve aktuale dërgon te njohja përfundimtare, a bëhet përmbyllja e dialogut në këtë format, nëse zbatohen marrëveshjet e arritura dhe a do të nënshkruhen marrëveshje të reja, derisa marrëveshjet e arritura nuk zbatohen?

Avni Arifi, duke iu referuar pyetjeve të deputetit Gorani, tha se Qeveria konsideron që është arritur një momentum, ku duhet të ketë një përmbyllje të dialogut në formatin dhe platformën ekzistuese, se duhet të implementohen marrëveshjet e arritura dhe pastaj të dalim në një stad të ri. Ai njoftoi se për orientim kanë implementimin e marrëveshjeve ekzistuese, porse ky nuk është vendim i prerë. Po ashtu, tha se ka shumë tema që dëshirojnë t'i bisedojnë dhe është edhe interes i Kosovës që të diskutohen shumë tema, mirëpo do të ishte mirë që këto të ndodhin në raporte tjera Kosovë – Serbi.

Dukagjin Gorani, tha se nëse prioritet i Qeverisë së Kosovës është përgatitja e bazës politike për arritjen e marrëveshjes përfundimtare për normalizim, atëherë qëllimi i këtij procesi të dialogut është njohja reciproke. Mirëpo, ky qëllim nuk është edhe qëllimi që e ka Qeveria e Serbisë. Z. Gorani, po ashtu, pyeti: A nënkupton kjo riformatizim të bisedimeve?

Avni Arifi, tha se qëllimi i këtij dialogu është normalizimi i raporteve Kosovë – Serbi. Ky normalizim nuk mund të ndodhë, nëse nuk kemi njohje reciproke. Ai njoftoi se janë duke punuar që të implementohen marrëveshjet ekzistuese. Niveli politik, tha se udhëhiqet nga Presidenti, se a do të ketë riformatizim, është vështirë të parashikohet.

Vjosa Osmani- Sadriu, pyeti: A është pozicioni i të gjitha institucioneve të vendit se normalizimi i raporteve nënkupton njohje reciproke?

Avni Arifi, tha se qëndrimi i Qeverisë është që, normalizimi është njohje reciproke.

Doruntinë Maloku- Kastrati, pyeti lidhur me qëndrimin e Listës Serbe, sa i përket themelimit të asociacionit të komunave serbe.

Avni Arifi, Lista Serbe është pjesë e Qeverisë së Kosovës, e cila kërkon arritjen e marrëveshjes për asociacionin e komunave. Pozicioni i tyre është që duan krijimin e asociacionit, si mjet për avancimin e pozitës së tyre në Kosovë.

Elmi Reçica, tha se dialogu është çështje shtetërore dhe në situata të caktuara del të jetë edhe çështje kombëtare. Ai tha se komisioni është i njoftuar me përgjegjësitë e shefit të ekipit negociator, se duhet kohë që të njihet me materien, për atë që është realizuar deri tani dhe atë që ka mbetur pa u realizuar. Ai kërkoi nga z. Arifi zbatimin e Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës dhe të mos diskutohet as sovraniteti i shtetit, as rregullimi i brendshëm territorial dhe të ketë qëndrim të qartë se nuk ka pushtete të mesme. Ai, po ashtu, kërkoi që komisioni të informohet për të gjitha zhvillimet, para se të merren vendimet.

Doruntinë Maloku- Kastrati, duke iu referuar një deklarami publik të z. Arifi, se në rast se Serbia vazhdon që të mos i implementojë marrëveshjet e arritura, Qeveria e Kosovës do të aplikojë një sërë restriksionesh. Lidhur me këtë, pyeti: Çfarë do të bëjë Qeveria e Kosovës, nëse Serbia vazhdon të mos i implementojë marrëveshjet e arritura?

Avni Arifi, lidhur me pyetjen e deputetes Maloku- Kastrati, tha se nuk i kujtohet se kur e ka thënë këtë, por mosimplementimi i marrëveshjeve të arritura ia humb kuptimin dialogut. Ai shtoi se dialogu është një raport i facilituar nga BE-ja dhe do të insistohet në implementimin e marrëveshjeve.

Time Kadrijaj, kërkoi që të mbahen takime, para dhe pas bisedimeve, sepse ajo që e ka dëmtuar imazhin e Kosovës për çështje që janë të rëndësishme ka qenë mostransparenca dhe mosbashkëpunimi i ngushtë i Kuvendit dhe i Qeverisë. Ajo tha se duhet respektuar Kushtetutën dhe ligjet e vendit në arritjen e marrëveshjeve, sepse e kemi parë fatin e marrëveshjes për asociacionin, në rast se nuk respektohet Kushtetuta. Më tej, shtoi se procesi duhet të jetë transparent dhe marrëveshjet që arrihen në Bruksel duhet të interpretohen, ashtu siç janë arritur dhe të transmetohen për publikun. Pa u implementuar të gjitha marrëveshjet e arritura, nuk ka kuptim fillimi i hartimit të marrëveshjeve të reja, theksoi ajo.

Avni Arifi, tha se arsyeja pse nuk po pranojmë të bisedojmë për marrëveshje të reja është se kemi ngecje në zbatimin e marrëveshjeve, siç është rasti me marrëveshjen për energji e datës 8 shtator 2013, e cila është shumë e rëndësishme për Kosovën.

Zafir Berisha, tha se të gjitha marrëveshjet e arritura janë antikushtetuese dhe ato duhet të dërgohen për interpretim në Gjykatën Kushtetuese. Ai theksoi se bisedimet me Serbinë kanë qenë për çështje të brendshme të Kosovës. Në vitin 2017, Kryeministri Haradinaj tha se është ndalë në Francë, si rezultat i një fletarresti të Serbisë, kurse me rezolutën e Kuvendit, të datës 9 mars 2017, është ngarkuar Qeveria që të kërkojë nga BE-ja, ta detyrojë Serbinë, që t'i anulojë të gjitha fletarrestet e lëshuara në Interpol, lidhur me qytetarët e Kosovës. Më tej, pyeti: A është realizuar ndonjëra nga kërkesat e Kuvendit që ne ta kemi një komoditet, për t'i vazhduar bisedimet politike të dëmshme për Kosovën? Ai shprehu mendimin se Kuvendi duhet ta diskutojë platformën dhe qasjen e Kosovës ndaj Serbisë.

Avni Arifi, tha se ai është i ngarkuar për bisedimet teknike, por raportet Kosovë – Serbi janë politike. Marrëveshja për drejtësi dhe cilado marrëveshje që mendoni që duhet të shkojë në Gjykatën Kushtetuese, është mirë të dërgohen dhe të rishikohen, shtoi z. Arifi. Lidhur me pyetjen e shtruar nga deputeti Berisha, sa i përket Interpolit, tha se nuk ka informacionin e plotë dhe do të përgjigjet në takimin tjetër të përbashkët, por shtoi se Policia e Kosovës e ka rritur bashkëpunimin me mekanizmat ndërkombëtarë të Interpolit dhe një numër i të përndjekurve, të akuzuar për krime lufte, janë larguar nga lista.

Vjosa Osmani- Sadriu, sa i përket dërgimit të marrëveshjeve në Gjykatën Kushtetuese, informoi se është një procedurë e komplikuar, nëse kjo bëhet përmes Kuvendit dhe do të ishte më lehtë, nëse bëhet përmes Kryeministrit. Ajo tha se në mekanizma të ndryshëm rajonalë e ndërkombëtarë po krijohet përshtypja se Kosova po ngec në implementimin e marrëveshjeve e jo Serbia dhe kërkoi nga Qeveria që të jetë më e zëshme, për ta treguar të vërtetën rreth implementimit të marrëveshjeve. Ajo

njoftoi se hartimi i statutit të asociacionit të komunave serbe në mandatin e kaluar ka ngecur, për shkak të bojkotit të plotë të palës serbe. Ajo pyeti: Kush është duke e udhëhequr aspektin politik të negociatave dhe a ka qëndrim Qeveria e Kosovës, që aspekti politik të udhëhiqet nga Presidenti i Kosovës? Kush do ta negociojë traktatin, i cili do të jetë juridikisht i obligueshëm për Kosovën? Kjo është një çështje shqetësuese, për shkak se Kuvendi i Kosovës nuk ka mekanizma për ta mbikëqyrur punën e Presidentit dhe në anën tjetër Presidenti nuk ka mekanizma implementues, ato i ka Qeveria.

Avni Arifi, pajtohet që në shumë mekanizma ndërkombëtarë është krijuar përshtypja se ngecjet janë te Kosova, por nëse flitet për një marrëveshje të caktuar, aty dihet saktësisht se pse nuk po implementohet. Lidhur me pyetjet e kryetares për nivelin politik të bisedimeve, tha se këto pyetje duhet të shtrohen në Kuvend.

Doruntinë Maloku- Kastrati, pyeti: Çfarë do të ndodhë nëse Qeveria e Serbisë vazhdon të mos implementojë marrëveshjen për targa e veturave, çfarë do të ndodh me rastin e Interpolit, si dhe çfarë vendimi do të marrë Qeveria e Kosovës në rast se Serbia vazhdon të mos i implementojë marrëveshjet e arritura me Kosovën?

Avni Arifi, sa i përket marrëveshjes për targa, njoftoi se ka ngecje nga ana e Kosovës, për shkak të procedurave të tenderimit. Sa i përket Interpolit, tha se të gjithë komandantëve të policisë që kanë pasur sjellje të keqe gjatë viteve 90-të, duhet t'u ngrihen akuza. Ai tha se prej tij po kërkohet që të deklarohet për një situatë hipotetike dhe shtoi se janë disa marrëveshje që duhet të implementohen. Ai, po ashtu, tha se nëse pyetet se a duhet të implementohet marrëveshja për targa, nëse Serbia nuk e implementon, tha se ajo nuk duhet të implementohet.

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se qëllimi i të gjithë neve, është që në tavolinë me Republikën e Serbisë të triumfojë Republika e Kosovës dhe qëndrimet e Republikës së Kosovës të jenë të ndërtuara nëpërmjet një konsensusi. Sa i përket listës së njerëzve që i është dërguar Interpolit nga Serbia, njoftoi se aty nuk ka vetëm të njerëz të UÇK-së, por ka edhe njerëz që kanë qenë të akuzuar në vitet 90-të, për shkak se kanë dalë kundër regjimit serb dhe kjo ka qenë arsyeja pse është kërkuar në rezolutën e Kuvendit të flitet për të gjithë qytetarët e Kosovës. Sa i përket targave, tha se sipas informatave të deritashme thuhet se Serbia nxjerr probleme të shumta në respektimin e marrëveshjes dhe nuk është ngecja vetëm nga ana e Kosovës.

Time Kadrijaj, tha se duhet të insistohet në implementimin e marrëveshjeve, por ka pengesa të mëdha në implementimin e tyre, që është vazhdimësi edhe e Qeverisë së kaluar.

Zafir Berisha, tha se janë bërë shumë marrëveshje që kanë sjellë shumë probleme të brendshme në Kosovë, si në aspektin politik, ashtu edhe në atë ekonomik dhe social. Serbia vazhdon t'i financojë strukturat paralele, edhe përkundër që ka një marrëveshje. Po ashtu, njoftoi se në rrethinë të Prishtinës arsimit vazhdon të financohet nga Serbia. Kjo është një dëshmi e mjaftueshme që Serbia nuk është duke i respektuar marrëveshjet. Ai shprehu mendimin se platforma e Qeverisë për bisedime shtesë duhet të kalojë në Kuvend.

4. Të ndryshme

Time Kadrijaj, tha se përmes një shkrese, drejtuar anëtarëve të komisionit, ka kërkuar që në këtë mbledhje, në rend dite të jetë intervistimi i kandidatit të propozuar për ambasador.

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se ky është një proces që bëhet në besim dhe se i ka dërguar letër ministrit të Jashtëm, për ta pyetur se kur do të ndërmerren masa që të respektohet kuota ligjore. Njoftoi se ka pranuar propozimin vetëm për një kandidat, të cilin do t'ua shpërndajë anëtarëve të komisionit. Znj.

Osmani- Sadriu, tha se ministri i Jashtëm, në mbledhjen e komisionit e pranoi që janë 4 vende vakante, nëse në ato 4 vende vakante dërgon ambasadorë të karrierës, atëherë arrihet kuota e paraparë ligjore dhe komisioni mund të thërrasë në intervistim kandidatin e propozuar.

Doruntinë Maloku- Kastrati, kërkoi një sqarim lidhur me emrat që janë dërguar vitin e kaluar te Presidenti për ambasadorë në Çeki dhe Gjermani. Ajo shtroi pyetjen: Tani, ministri i Jashtëm ka dërguar emra të rinj, çfarë do të ndodhë me emrat e propozuar më parë?

Vjosa Osmani Sadriu, duke iu referuar pyetjes së deputetes Maloku, tha se komisionit i duhet përgjigje zyrtare nga Presidenti, sepse nuk mund të ketë dy emra të propozuar për të njëjtën pozitë.

Elmi Reçica, tha se mandati i komisionit është intervistimi i kandidatëve për ambasadorë, të cilët i propozon MPJ dhe i dekreton Presidenti. Shprehu mendimin se kandidati i propozuar nga MPJ duhet të ftohet në intervistim. Komisioni duhet ta bëjë raportin, t'i dërgohet Presidentit, pastaj Presidenti e merr përgjegjësinë. Ministri i Jashtëm ka deklaruar këtu diçka, por prapë e ka sjellë, tani çështja është te ne.

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se ministri i Jashtëm e pranoi që ka shkelje, atëherë po e presim përgjigjen me shkrim, që ta sqarojë këtë çështje. Ajo shtoi se nuk mund ta thërrasë mbledhjen e komisionit dhe të bëhet pjesë e shkeljeve ligjore, përkundër respektit që mund të ketë për personat që propozohen

Time Kadrijaj, tha se kjo është një procedurë kalimtare e intervistimit. Ne duhet ta kryejmë punën tonë, e në punën e Presidentit dhe të MPJ-së nuk mund të ndërhyjmë. Ajo kërkoi që të vendoset në votim propozimi, që në mbledhjen e radhës, të jetë pikë e rendit të ditës, intervistimi i kandidatit të propozuar për ambasador.

Elmi Reçica, tha se komisioni ka formuar grupin punues për ta mbikëqyrë zbatimin e Ligjit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, dhe nëse ka shkelje ligjore, grupi do ta konstatojë dhe do ta raportojë në seancë plenare. Meqë ka ardhur një propozim nga MPJ, komisioni duhet ta kryejë punën e tij dhe ta përcjellë atë tutje, shtoi z. Reçica. Ai tha se nëse komisioni e sheh të arsyeshme, në raport mund të shtohet vërejtja, që është tejkaluar kuota ligjore.

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se ministri i Jashtëm në raportimin e tij paralajmëroi se shumë shpejt do të plotësohen vendet vakante me ambasadorë karriere, në mënyrë që kjo kuotë të respektohet. Ajo shprehu mendimin se duhet të pritët përgjigja nga ministri, dhe nëse plotësohet kuota, atëherë komisionit mund ta ftojë personin që është propozuar për intervistim.

Dukagjin Gorani, tha se paqartësia rreth proporcionit politik dhe të karrierës, traditën e vet e ka në mënyrën sesi bëhet përzgjedhja e stafit civil dhe politik në historinë e qeverisjes edhe të institucioneve shtetërore në Kosovë. Ai shtoi se ka ambasadorë, të cilët janë të emëruar politikë e nuk i takojnë asnjë partie politike. Po ashtu, ka edhe ambasadorë të karrierës, për të cilët të gjithë e dimë që marrin pjesë edhe në zgjedhje. Ai shtoi se komisioni duhet të përqendrohet më shumë në cilësinë e individit sesa në respektimin e parimit.

Doruntinë Maloku- Kastrati, tha se në Gjermani është emëruar ushtruesi i detyrës së ambasadorit dhe nuk po sheh ndonjë nguti që të futet kjo çështje në rend dite. Kërkoi që kryetarja e komisionit t'i dërgojë një letër Presidentit dhe të kërkojë sqarim, se për cilat shtete ekzistojnë emra që janë dërguar prej komisionit apo prej MPJ, për t'u emëruar ambasador, pse ka ngecur kjo dhe se a janë refuzuar ata emra, në mënyrë që të dimë se për cilat shtete bëhet fjalë.

Zafir Berisha, tha se nuk po e kupton pse është shkelje ligjore, nëse Qeveria e ka dhënë një propozim dhe ne e trajtojmë. Ai shtoi se shkelje ligjore mund të jetë, nëse Qeveria e tërheq kandidatin dhe ne e thërrasim të njëjtin për intervistim.

Evgjeni Thaçi- Dragusha, tha se nuk është e drejtë që disa anëtarë të komisionit kanë njohuri se kush është ai person dhe e paragjykojnë se është i karrierës ose politik.

Mbledhja përfundoi në orën 14:50.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetarja komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu